



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar më: 04.04 20 25		
Prilmeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-03006-14865		

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 pika k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 5 janar 2024, Ligjit nr.2004/32 për Familjen e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.4 e datës 01 shtator 2006, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për familjen nr.2004/32 për familjen e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 3 e datës 17 janar 2019, Ligjit për Mbrojtjen e fëmijës Nr.06/L-084, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 14 e datës 17 korrik 2019 si dhe neneve 9 pika k) dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2025, të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT KOMUNAL PËR STREHIM FAMILJAR PËR KOMUNËN E LIPJANIT 2025-2027

Neni 1

MIRATOHET ,Plani i veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit 2025-2027.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit 2025-2027.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale- Qendra për Punë Sociale në Lipjan .

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 dhe 17 pika k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare Nr.08/L-255 , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.1 e datës 5 janar 2024, Ligjit nr.2004/32 për Familjen e Kosovës Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.4 e datës 01 shtator 2006, Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për familjen nr.2004/32 për familjen e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 3 e datës 17 janar 2019, Ligjit për Mbrojtjen e fëmijës Nr.06/L-084, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 14 e datës 17 korrik 2019 si dhe neneve 9 pika k) dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Plani i Veprimit për Strehimin Familjar është një strategji gjithëpërfshirëse që synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mirëqenies për fëmijët pa kujdes prindëror.

Me Vendim të Kryetarit të Komunës është themeluar grupi punues për hartimin e Draft-Planit të veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit 2025-2027 i cili dokument ka qenë edhe në diskutim publik konform procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 050/06-14865
Lipjan, Më 04.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Komuna e Lipjanit

**PLANI I VEPRIMIT KOMUNAL PËR STREHIM FAMILJAR
PËR KOMUNËN E LIPJANIT
2025-2027**

Lipjan 2025

Përmbledhje ekzekutive	2
Baza ligjore dhe nënligjore që e rregullon fushën e strehimit familjar	4
Korniza e akteve ligjore	6
Instrumentet ndërkombëtare.....	6
Konteksti lokal lidhur me formën e mbrojtjes – strehimit familjar.....	6
Konteksti specifik dhe kapacitetet e Drejtorisë Komunale për shëndetësi dhe përkujdesje sociale dhe Qendrës për Punë Sociale.....	8
Metodologjia e hartimit të planit të veprimit lokal	8
Objektivat e Planit Komunal të veprimit për Strehim Familjar në Komunën e Lipjanit (2025-2027)	8
Matrica e planit të veprimit	11

Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Lipjanit është ndër komunat e Republikës së Kosovës që ka marrë iniciativa dhe veprime për zhvillimin e mëtejshëm të strehimit familjar, përfshirë këtu të gjitha fazat që rregullojnë strehimin familjar dhe atë në farefis. Për të përmbushur detyrimet ligjore dhe për të siguruar funksionimin e duhur të këtij shërbimi, është hartuar një plan i veprimit që synon informimin, identifikimin, rekrutimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të familjeve strehuese dhe akterëve që ofrojnë këtë shërbim, duke u mbështetur në një qasje të strukturuar dhe të planifikuar. Ky dokument ka për qëllim promovimin e strehimit familjar si një formë mbrojtjeje sociale dhe juridike, si brenda, ashtu edhe jashtë familjes biologjike.

Plani i Veprimit për Strehimin Familjar është një udhëzues strategjik që përfshin institucionet lokale, si Drejtoritë komunale, me udhëheqjen nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Qendra për Punë Sociale dhe partnerë të tjerë, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe komunitetin. Këto institucione bashkëpunojnë për të zbatuar masa që garantojnë mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për kujdesin e tyre.

Dokumenti përmban element të qartë, si qëllimin, objektivat, aktivitete dhe matrica të veprimeve konkrete, të cilat do të zbatohen nga institucionet komunale dhe partnerët e specializuar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe strehimit familjar. Gjithashtu, ky plan përfshin angazhimin e akterëve në nivelet lokale dhe qendrore për promovimin e strehimit familjar, ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e tij dhe rritjen e vetëdijes mbi nevojën për përkujdesje të përkohshme për fëmijët pa kujdes prindëror.

Qëllimi kryesor i planit është zhvillimi dhe avancimi i mëtejshëm i shërbimit të strehimit familjar në Komunën e Lipjanit. Përmes tij synohet rritja e numrit të familjeve strehuese në Kosovë dhe sigurimi i kujdesit për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Hartimi i planit është bërë në përputhje me ligjet përkatëse, përfshirë Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligjin për Familjen, si dhe aktet nënligjore dhe strategjitë e organizatave si SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës.

Në thelb, Plani i Veprimit për Strehimin Familjar është një strategji gjithëpërfshirëse që synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe mirëqenies për fëmijët pa kujdes prindëror. Ai adreson sfidat me të cilat përballen fëmijët në sistemin e strehimit familjar, duke krijuar një mjedis të sigurt, mbështetës dhe edukues për zhvillimin e tyre.

Komponentët kryesor të planit të veprimit të strehimit familjar përfshinë një sërë elementesh nëpërmjet së cilëve synohet që:

- Të ngritët vetëdijesimi dhe informimi i opinionit për formën e mbrojtjes juridike dhe sociale strehimi familjar
- Mënyrën më të mirë për informim dhe përzgjedhjen e familjeve strehuese
- Trajnimin e familjeve strehuese duke u ofruar atyre trajnimin dhe mbështetjen e duhur për të plotësuar nevojat e fëmijëve në kujdesin e tyre.
- Sigurimin e shërbimeve të zgjeruara mbështetëse përmes burimeve dhe shërbimeve shtesë që do t'ju ofrohen familjeve strehuese, duke përfshirë këshillimin, mbështetjen e shëndetit mendor dhe kujdesin e kohëzgjatjen e qëndrimit, për t'i ndihmuar ato të adresojnë më mirë nevojat unike të fëmijëve të strehuar pa kujdes familjar.
- Vendorsja në kohë dhe qëndrueshmëri: Do të merren masa për të siguruar që fëmijët të vendosen në familje të përshtatshme strehuese sa më shpejt që të jetë e mundur, duke minimizuar ndërprerjet e kujdesit dhe duke promovuar stabilitetin në jetën e tyre.
- Arsimi dhe kujdesi shëndetësor: Do të ndërmerren hapa për përmirësimin e mundësive arsimore për fëmijët e strehuar, si siguri i stabilitetit në shkollë dhe ofrimi i mbështetjes pedagogjike-arsimore shtesë. Qasja në shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë kontrollet e rregullta dhe kujdesin për shëndetin mendor, është gjithashtu prioritar.
- Mbështetja e tranzicionit: Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përgatitjes së të rinjve të strehuar në prag të arritjes së moshës madhore për pavarësi, duke ofruar trajnime për aftësitë e jetesës gjysmë të pavarur dhe të pavarur, udhëzime në karrierë dhe mbështetje me strehim afatgjatë dhe punësim.
- Bashkëpunimi dhe koordinimi: Plani i veprimit thekson bashkëpunimin ndërmjet sektorëve të mirëqenies së fëmijëve, ofruesve të kujdesit të strehimit familjar, shkollave dhe palëve të tjera të interesuara për të siguruar një qasje të koordinuar dhe tërësore për mbështetjen e fëmijëve në proces të strehimit familjar.
- Mbledhja dhe monitorimi i të dhënave: Janë krijuar sisteme të fuqishme të mbledhjes së të dhënave për të gjurmuar mirëqenien dhe përparimin e fëmijëve pa kujdes prindëror, duke mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të efektivitetit të planit të veprimit.
- Mirëmbajtja e familjeve strehuese ekzistuese dhe në farefis: Në kuadër të planit të veprimit, mirëmbajtja e familjeve strehuese ekzistuese dhe atyre në farefis do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe dinamik, i cili do të fillojë me

një vlerësim që do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë nevojat e tyre specifike, kapacitetet që kanë dhe sfidat me të cilat përballen.

- Prioritizimi i familjeve strehuese për shërbime themelore është një aspekt jetik i planit të veprimit. Kjo do të thotë se familjet strehuese do të kenë përparësi në qasjen ndaj shërbimeve të tilla si kujdesi shëndetësor, arsimi, shërbimet sociale dhe strehimi. Duke u dhënë përparësi atyre, ne sigurojmë që fëmijët që jetojnë në këto familje të marrin mbështetjen e nevojshme për të pasur një jetë të shëndetshme dhe të zhvilluar. Kjo gjithashtu ndihmon në lehtësimin e barrës mbi familjet strehuese, duke u lejuar atyre të fokusohen në ofrimin e një mjedisi të dashur dhe të qëndrueshëm për fëmijët.
- Avokimi për njohjen e profesionit të prindërve strehues është një shtyllë e rëndësishme e planit të veprimit. Kjo do të thotë se do të punohet në nivel legjislativ dhe me institucionet e nivelit qendror për të arritur njohjen e prindërve strehues si profesion, duke përfshirë këtu të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo. Njohja e profesionit të prindërve strehues do të rrisë vlerësimin dhe mbështetjen për punën e tyre të paçmuar, si dhe do të ndihmojë në krijimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe profesional për kujdesin ndaj fëmijëve në nevojë. Kjo gjithashtu mund të çojë në standardizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve për prindërit strehues si ofrues të drejtperdrejt të kujdesit social, duke siguruar një kujdes sa më cilësor për fëmijët.

Baza ligjore dhe nënligjore që e rregullon fushën e strehimit familjar

Duke zbatuar këto objektiva, elemente, aktivitete, plani i veprimit për strehim familjar synon të përmirësojë cilësinë e përgjithshme të kujdesit për fëmijët në strehim familjar dhe atë në farefis, të rrisë mirëqenien e tyre dhe të rrisë shanset e tyre për të gjetur një familje dhe shtëpi të qëndrueshme dhe të përhershme.

Aktet ligjore në Kosovë ofrojnë një rregullim gjithëpërfshirës për strehimin familjar për fëmijët pa kujdes prindëror. Ligjet kryesore që përfshijnë këtë rregullim janë Ligji i Familjes nr. 2004/32¹ (2006), Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare nr. 08/L-255² (2024) Udhëzimi administrativ për Strehim Familjar dhe Adoptim. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës³.

Legjislacioni rregullon aspektet e mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë ata pa kujdes prindëror, definojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve lokale dhe qendrore, sikurse edhe akterëve tjerë në zbatimin e masave ligjore të strehimit familjar të fëmijëve pa kujdes prindëror. Në Ligjin e Shërbimeve Sociale ne nenin 19 paragrafin

¹ Ligji për shërbime sociale dhe familjare 08/ L – 255 Gazeta Zyrtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85111> ² Ligji i Familjes i Kosoves – Gazeta Zyrtare <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>

³ Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

3.1 përkufizohet strehimi familjar citojmë: "strehimi familjar brenda apo jashtë familjes biologjike ku fëmijës ose të rriturit i sigurohet strehim dhe kujdes në mjedis familjar. Shërbimet e banimit përfshijnë pritjen, banimin, ushqimin, veshmbathjen, higjienën, kujdesin në dhomë, kujdesin për shëndetin, kujdestarinë, edukimin, aktivitetet e punës, rehabilitimin psiko-social dhe kohën e lirë" po ashtu në nenin 22 strehimi familjar precizohet citojmë: neni 22 Strehimi familjar paragrafët :

1. Strehimi familjar është formë e mbrojtjes dhe ofrimit të shërbimit social jashtë familjes biologjike dhe tek të afërmit me të cilën fëmijës apo personit të rritur i sigurohet strehimi dhe përkujdesja para së gjithash në rrethin familjar në pajtim me ligjin.
2. Strehimi për fëmijë dhe të rinj përfshinë edhe përgatitjen për kthimin tek prindërit, rregullim tjetër të përhershëm jetësor dhe përgatitjen për jetë të pavarur.

Në Ligjin për Vetëqeverisje lokale në neni 17 pika K, shërbimet sociale janë kompetence vetanake e Komunës, përfshirë edhe strehimin familjar. Andaj, Komuna duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të fuqizuar dhe ofruar shërbimin për fëmijët pa kujdes prindëror.

Komuna ka një rol kyç në zbatimin e shërbimit të strehimit familjar dhe atij në farefis, duke mbajtur përgjegjësi dhe obligime ligjore për të siguruar që ky shërbim të funksionojë në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme. Përmes Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS), komuna është përgjegjëse për identifikimin e fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje, përzgjedhjen e familjeve strehuese, si dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të mirëqenies së fëmijëve të vendosur në këto familje.

Një nga detyrat kryesore të komunës është sigurimi i mbështetjes financiare për familjet strehuese, duke respektuar kriteret e përcaktuara në Udhëzimet Administrative. Komuna duhet të garantojë një proces transparent dhe të drejtë në identifikimin dhe përzgjedhjen e familjeve strehuese, si dhe të krijojë mekanizma për monitorimin dhe mbështetjen e tyre. Për më tepër, komuna ka për obligim të organizojë fushata ndërgjegjësuese për të informuar komunitetin lokal mbi rëndësinë e strehimit familjar dhe për të nxitur pjesëmarrjen e familjeve të reja.

Komuna gjithashtu duhet të bashkëpunojë me nivelin qendror dhe akterët e tjerë, përfshirë OJQ-të dhe organizatat komunitare, për të ndërtuar kapacitete lokale dhe për të siguruar që punëtorët socialë të jenë të trajnuar dhe të pajisur me burimet e nevojshme për të menaxhuar rastet e fëmijëve dhe familjeve strehuese. Në zbatim të këtyre përgjegjësisë, komuna duhet të harmonizohet me ligjet në fuqi, si Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Ligji për Familjen, duke harmonizuar veprimet e saj me politikat kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Në tërësi, obligimet e komunës lidhen me krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme mbështetëse që garanton sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, duke ndihmuar familjet strehuese të plotësojnë këtë mision të rëndësishëm social.

Çështja e strehimit familjar dhe përkujdesjes së fëmijëve pa kujdes prindëror është akoma sfidë për shoqërinë Kosovare, dhe për institucionet respektive.

Korniza e akteve ligjore

Legjislacioni në fuqi që përcaktojnë dhe rregullojnë fushën, por dhe përgjegjësitë e detyrimet e institucioneve lokale e qendrore në ofrimin e shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nevojë dhe pa kujdes prindëror

- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës
- Ligji i Familjes
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës
- Ligji për Shëndetësi
- Ligji i Punës
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal

Aktet nën ligjore dhe dokumentet

- Udhëzimet administrative përkatëse për strehimin familjar dhe adoptimin.
- Standardet profesionale

Instrumentet ndërkombëtare

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës
- Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Adoptimin Ndërkombëtar
- Konventa Evropiane për Adoptimin e Fëmijës (e Këshillit të Evropës)
- Udhëzuesi i Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ
- Korniza Evropiane Vullnetare e Cilësisë për Shërbimet Sociale

Konteksti lokal lidhur me formën e mbrojtjes – strehimit familjar

Komuna e Lipjanit ka pasur vazhdimisht nevoja dhe kërkesa për strehimin familjar si formë mbrojtjeje për fëmijët. Pavarësisht përpjekjeve dhe adresimeve të deritanishme, komuna ka ende nevojë për zhvillimin dhe avancimin e formave të mbrojtjes së fëmijëve. Pozicioni gjeografik i Lipjanit, përfshirë afërsinë me aeroportin dhe qendrën korrektuese, si dhe rastet e migrimit që prekin territorin e saj, krijojnë një dinamikë specifike që rrit kërkesën për mekanizma më të strukturuar dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve. Këto sfida kërkojnë përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar kapacitetet dhe shërbimet, duke garantuar që nevojat e fëmijëve dhe familjeve strehuese të adresohen në mënyrë efektive.

Projeksionet për ekonominë dhe punësimin në komunë tregojnë një tendencë modeste, e cila nënkupton rritje të ngadaltë ekonomike dhe kufizime të ndjeshme në krijimin e vendeve të reja të punës. Kjo situatë përforcon kufizimet buxhetore dhe shton presionin mbi shërbimet sociale, pasi resurset e kufizuara nuk mund të përballojnë kërkesat në rritje për mbështetje. Varfëria dhe problemet sociale janë në rritje, ndërsa

nevojat për ndërhyrje dhe zgjidhje mbeten të vazhdueshme. Pandemia e COVID-19 ka rënduar edhe më tej situatën, duke shkaktuar një rritje të ndjeshme të kërkesave për shërbime publike, përfshirë shërbimet sociale. Si pasojë, Qendra për Punë Sociale (QPS) është përballur me mbingarkesë, ndërsa nevojat për mbështetje kanë shënuar rritje në të gjitha kategoritë e fëmijëve dhe familjeve.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta, Komuna e Lipjanit ende nuk ka arritur të përmbushë nevojën për identifikimin dhe angazhimin e familjeve të reja strehuese. Ky boshllëk krijon një sfidë të vazhdueshme në ofrimin e mbrojtjes dhe përkujdesjes për fëmijët që kanë nevojë për strehim.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, është thelbësore të zhvillohen dhe forcohen kapacitetet lokale të Drejtorive Komunale, QPS-së, punëtorëve social, si dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve sociale nga radhët e OJQ-ve dhe profesionistëve të licencuar. Në veçanti, duhet të rritet ndërgjegjësimi publik për rëndësinë e strehimit familjar si një formë efektive e mbrojtjes për fëmijët në nevojë. Përmes programeve të specializuara dhe trajnimeve, mund të arrihet një përmirësim në cilësinë e këtyre shërbimeve, duke garantuar mbështetje më të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e prekura.

Ndërkaq, mes tjerash, Komuna e Lipjanit ka arritur që:

- Të nënshkruajë marrëveshje me SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës për strehimin familjar
- Ofruar shërbime për 3 fëmijë, nga të cilët njëri ka shkuar në adoptim, ndërsa aktualisht janë 1 fëmijë nën përkujdesje në familje strehuese dhe 2 në farefis;
- Të trajnojë 10 zyrtarë komunale në trajnimet me programin Mini Pride.
- Të nënshkruajë marrëveshje me OFAP për strehimin familjar

Qendra për Punë Sociale (QPS) në Lipjan përballlet me një sërë sfidash që e bëjnë të vështirë ofrimin e mbështetjes së nevojshme për familjet strehuese. Një nga sfidat kryesore është pamjaftueshmëria e mbështetjes financiare të ofruar nga shteti për këto familje, gjë që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimit të strehimit familjar. Për më tepër, QPS vuan nga mungesa e stafit dhe e kohës së mjaftueshme për t'u dedikuar mbështetjes së vazhdueshme për familjet dhe fëmijët në përkujdesje.

Një tjetër sfidë është identifikimi dhe përzgjedhja e familjeve të reja strehuese, proces i cili kërkon përzgjedhje të vazhdueshme të familjeve strehuese dhe përkushtim të vazhdueshëm. Vështirësitë për të ngritur vetedijen e komuniteti rreth strehimit familjar gjetur familje të gatshme dhe të përshtatshme për të strehuar fëmijë janë shtuar nga mungesa e resurseve perakrahe për ndërgjegjësim dhe promovim të vazhdueshëm të këtij shërbimi në komunitet.

Për të adresuar këto sfida, QPS Lipjan ka theksuar nevojën për disa masa kyçe: një vlerësim më sistematik të nevojave të familjeve aktuale dhe potenciale për strehim, krijimin e kontakteve të qëndrueshme me familje që plotësojnë kushtet për strehim, si dhe zhvillimin e masave specifike që tërheqin dhe bindin familjet e reja të marrin

pjesë në këtë formë mbrojtjeje. Po ashtu, është jetike organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe promovuese, përfshirë takimet në terren me qytetarët dhe përdorimin e formave të tjera komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesimin për strehimin familjar.

Konteksti specifik dhe kapacitetet e Drejtoratit Komunal për shëndetësi dhe përkujdesje sociale dhe Qendrës për Punë Sociale

Numri i madh i kërkesave për shërbime sociale kërkon edhe resurse profesionale të mjaftueshme. Aktualisht Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Qendra për Punë Sociale, përballen edhe me sfidën e mungesës së stafit. Në momentin e zhvillimit të këtij plani të veprimit stafi profesional i angazhuar në QPS është 4 zyrtarë të shërbimeve sociale profesionale. Përderisa në DSHMS, aktualisht janë të angazhuar 2 staf përgjegjës për sigurimin e shërbimeve në Komunë.

Metodologjia e hartimit të planit të veprimit lokal

Fillimisht është realizuar një analizë paraprake e gjendjes dhe kontekstit lokal në Komunën e Lipjanit, me fokus specifik në sferën e mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrimin e shërbimit të strehimit familjar për fëmijët pa kujdes prindëror.

Hapat për hartimin dhe finalizimin e planit

- Rishikimi dhe konsultimi i legjislacionit primar dhe sekondar
- Takimet konsultuese dhe informuese me përfaqësuesit e institucioneve lokale në Komunën e Lipjanit.
- Përcaktimi i grupit punues.
- Përcaktimi i qëllimit, objektivat specifike dhe hartimi i planit
- Punëtoritë dhe përpunimi i draftit të planit të veprimit
- Hartimi dhe finalizimi i planit

Objektivat e Planit Komunal të veprimit për Strehim Familjar në Komunën e Lipjanit (2025-2027)

Rritja e numrit të familjeve strehuese në komunë

Identifikimi i së paku 20 familjeve për strehim familjar (2025), përgatitja e së paku 30 prindërve strehues (2026) dhe rekrutimi i së paku 7 familjeve deri në fund të vitit 2027, kështu, Komuna e Lipjanit synon të rrisë numrin e familjeve strehuese përmes identifikimit dhe rekrutimit të familjeve të reja nëpërmjet bashkëpunimit me bashkësitë lokale, fetare dhe këshillat e prindërve. Ky proces do të përfshijë edukimin, trajnimin dhe certifikimin e familjeve potenciale, me qëllim krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Mirëmbajtja e familjeve strehuese ekzistuese dhe atyre në farefis

Komuna synon të përmirësojë kushtet e jetesës dhe të mbështesë familjet strehuese ekzistuese dhe ato në farefis deri në fund të vitit 2027. Në këtë kuadër, familjet do të përfitojnë nga shërbime psiko-sociale dhe supervizime të rregullta, si dhe do të ofrohen pako ushqimore, higjienike dhe materiale didaktike, për të siguruar një mbështetje gjithëpërfshirëse.

Krijimi i fondit emergjent për shërbime sociale

Deri në fund të vitit 2025, Komuna do të krijojë një fond emergjent për shërbimet sociale, i cili do të jetë funksional dhe i gatshëm për të adresuar nevojat e familjeve strehuese dhe fëmijëve në situata urgjente. Ky fond do të garantojë një siguri financiare dhe lehtësi në zbatimin e programeve të mbrojtjes sociale.

Prioritizimi i familjeve strehuese për marrjen e shërbimeve të nevojshme

Brenda vitit 2025, familjet strehuese dhe të rinjtë që dalin nga kujdesi do të kenë qasje të lehtë dhe të barabartë në shërbimet publike përmes kartave të identifikimit të posaçme. Kjo do të përfshijë lirim nga obligimet financiare për shërbime komunale dhe përfitimin e qasjes së shpejtë në shërbime arsimore, shëndetësore dhe sociale.

Sigurimi i mjeteve të mjaftueshme financiare për mbështetjen e Familjeve Strehuese në Lipjan

Komuna e Lipjanit do të angazhohet për njohjen institucionale të profesionit të prindërve strehues deri në fund të vitit 2027. Ky objektiv përfshin zhvillimin e një kërkesë të përbashkët dhe avokimin e saj pranë institucioneve relevante, për të siguruar një status profesional për këta individë dhe për të rritur cilësinë e kujdesit të ofruar.

Ngritja e nivelit të vetëdijesimit për rëndësinë e strehimit familjar

Nga momenti i aprovimit të këtij Plani, Komuna do të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuere dhe promovuese për të rritur nivelin e vetëdijesimit publik për rëndësinë e strehimit familjar. Këto përfshijnë sesione informuese, materiale promovuese, paraqitje në media dhe përdorimin e platformave online për të nxitur gatishmërinë e komunitetit për të kontribuar në këtë formë mbrojtjeje.

Alokimi i mjeteve financiare për mbështetjen e familjeve strehuese

Komuna synon të sigurojë fonde të qëndrueshme për mbështetjen e familjeve strehuese në vazhdimësi. Kjo do të arrihet përmes subvencionimit, kontraktimit të partnerëve për shërbime sociale dhe identifikimit të donatorëve potencialë, duke garantuar zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve për këto familje.

Përfshirja e fëmijëve në strehim në institucione parashkollore dhe shkollore

Deri në fund të vitit 2027, të gjithë fëmijët në kujdesin e familjeve strehuese do të integrohen në institucione arsimore parashkollore dhe shkollore. Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike dhe private, si dhe organizatat joqeveritare, do të ofrohet mbështetje për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe për të siguruar qasje në arsim cilësor.

Sigurimi i mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara

Komuna e Lipjanit do të sigurojë mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara deri në vitin 2027, përmes pajisjeve ndihmëse, qasjeve infrastrukturore dhe shërbimeve të specializuara si fizioterapia, asistenti edukativ dhe shërbimet psikologjike. Këto masa do të synojnë krijimin e mundësive të barabarta për këta fëmijë në mjedisin arsimor dhe social.

Ngritja e kapaciteteve të akterëve relevantë

Deri në vitin 2027, Komuna do të zhvillojë trajnime dhe supervizime të rregullta për punëtorët socialë dhe aktorët kyç të përfshirë në shërbimet e strehimit familjar. Organizimi i vizitave studimore dhe shkëmbimit të përvojave do të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve profesionale për menaxhimin e shërbimeve sociale në nivel lokal dhe kombëtar.

Matrica

Objektivi	Aktivitetet	Detyrat - Veprimet	Afati Kohor	Treguesi i matjes	Rezultati	Kosto financiare	Institucionet e përfshira
Rritja e numrit të strehuese në komunë	1. Identifikimi dhe referimi i familjeve strehuese 2. Përgatitja, rekrutimi, edukimi/trajnimi dhe informimi i familjeve strehuese potenciale	1. Zhvillimi i takimeve informative dhe vetdijësuese me bashkësitë lokale, fetare dhe këshillave të prindërve 2. Hartimi i listës me Familjet Strehuese potenciale 3. Ofrimi i trajnimeve të programit PRIDE 4. Ofrimi i trajnimeve me programin STANDARD te Strehimit familjar	2025-2027	- Numri i familjeve potenciale të identifikuar - Certifikimi i se paku 3 familjeve strehuese të reja - Brenda tri viteve, të gjitha familjet në farefis që kanë fëmijë në kujdes të kenë të përfunduar trajnimin Mini PRIDE - Numri i takimeve me akterët relevant	Rritja e numrit të strehuese aktive Rritja e cilësisë së kujdesit të ofruar nga familjet strehuese të certifikuar Rritja e numrit të familjeve strehuese potenciale; Rritja e vetdijësimin dhe informimit Rritja e numrit të familjeve të trajnuara	~ 3,000€	Këshillat lokal; Komuniteti fetar; Këshilli i prindërve; DSHMS; QPS; OJQ; OFAP

Mirëmbajtja e familjeve strehuese ekzistuese dhe atyre në farefis	1. Shërbime psiko-sociale/supervizion falas për prindërit strehues sipas nevojës – së paku një herë në dy muaj 2. Marrëveshje bashkëpunimi me OJQ për përkrahjen e Familjeve Strehuese përmes pakove të ndryshme 3. Mbështetje financiare mujore për fëmijët në Strehim familjar, në	1. Realizimi i vizitave në familjet strehuese 2. Ofrimi i pakove/produte ve ushqimore, higjienike, materialeve didaktike 3. Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, edukative dhe shëndetësore nëpërmjet ofruesve të shërbimeve sociale 4. Ekzekutimi i pagesave në baza mujore në shumë prej 350€/muaj;	2025-2027	Lista e përditësuar e familjeve të identifikuar; -së paku 1 vizitë në dy muaj -së paku 4 pako në vit -së paku 1 herë në muaj për familje - Transferi i mjeteve tek fëmijët përfitues	Përmirësimi i kushteve të jetesës së familjeve strehuese ekzistuese dhe atyre në farefis dhe ofrimi i e lehtësirave dhe qasje në shërbime Përmirësimi i kushteve dhe plotësimi i nevojave të fëmijëve në strehim familjar;	350€/muaj për familjet strehuese (mbulohet nga DSHMS) ~ 1500€ (shërbimet shëndetësore mbulohet nga SOS) ~ 1500€ (supervizio ni mbulohet nga SOS) ~	Komuna; DSHMS; QPS; OJQ; OFAP
---	---	---	-----------	---	--	--	-------------------------------

Krijimi i fondit emergjent për shërbime sociale/MR	shumë prej 350€/muaj për fëmijë	Hartimi i para masës dhe parallogarisë, dedikimi i mjeteve dhe procedurat e prokurimit për kontratën kornize dhe implementimi i saj	1. Përfshirja e situacionit në buxhetin e vitit përkatës 2. Hartimi i deklarës së disponueshmeris e së fondeve 3. Publikimi i thirrjes publike për ofertim 4. Vlerësimi dhe përgjdhja e operatorit ekonomik 5. Caktimi i ekipit menaxhues të kontratës 6. Plani për menaxhimin e kontratës	2025-2027	-kontraktimi i operatorit ekonomik	Krijimi i një fondi emergjent funksional dhe i disponueshëm për nevojat e familjeve strehuese	~ 1800€	DSHMS; Drejtoria e Financave; Zyra e Prokurimit;
Prioritizimi i Familjeve Strehuese për marrjen e	1. Kartë identifikimi për familjet strehuese dhe	1. Kërkesa për shtypjen e kartelave të identifikimit për		2025-2027	-qasja e shpejtë në shërbimet e nevojshme për	Qasje e shpejtë dhe e barabartë në shërbime për		DSHMS; QMKF, QMF dhe AMF; KPF;

shërbimeve të nevojshme (komunal, shkollim, shëndetësi, etj.)	të rinjtë që dalin nga kujdesi 2. Marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrjet publike lokale përkatëse për lirim e Familjeve Strehuese nga obligimet financiare...	Familjeve Strehuese dhe të rinjtë që dalin nga kujdesi 2. Pajimi i familjeve strehuese me kartelë 3. Informimi i akterëve për rëndësinë dhe funksionin e kartelave 4. Të iniciohet propozim vendimi për lirim nga taksat administrative komunale në Kuvendin Komunal 5. Lidhja e MoU me ndërmarrjet publike lokale për lirim nga obligimet;	Familjeve Strehuese -miratimi/hyrja në fuqi e vendimit për lirim nga taksat komunale -implementimi i MoU me NPL	familjet strehuese	Kuvendi Komunal; Kabineti kryetarit Ndërmarrjet publike lokale
Avokimi për njohjen e profesionit të	1. Zhvillimi i takimeve me	1. Takimi me komisionin parlamentar për	-dorëzimi i kërkesës së përbashkët tek	Njohja institucionale e profesionit të	LQPS; QPS; AKK;

Prindërve Strehues	akterë relevant (lidhja e QPS) 2. Nënshkrimi i kërkesës së përbashkët me partner (QPS) për njohjen e profesionit të Prindërve Strehues për Asociacionin e Komunave, IAP	shëndetësi dhe mirëqenie 2. Takime me ministrinë e linjës 3. Realizimi i takimeve koordinuese mes AKK dhe LQPS 4. Përpilimi i kërkesës	akteret relevant -njohja e profesionit	Prindërve Strehues	IAP;
Ngritja e nivelit të vetëdijesimit për rëndësinë e strehimit familjar	1. Sesione informuese brenda dhe jashtë QPS 2. Vizita dhe takime me bashkësitë lokale dhe fetare 3. Zhvillimi i materialeve promovuese dhe informuese për SF	1. Realizimi i sesioneve (në shtand, diskutime publike, ligjërata në shkollë, këshilli i prindërve) 2. Dizajnimi dhe shtypja e broshurave dhe materialeve të tjera promovuese 3. Pjesëmarrja në intervista në mediat lokale	-Rritja e numrit të Familjeve Strehuese	Përmirësimi i njohurive publike mbi rolin e familjeve strehuese dhe rritja e gatishmërisë për kontribuar	DSHMS; QPS; DKA; Këshilli i prindërve; Zyra e mediave; OJQ

	4. Paraqitja në medie 5. Sesione informative dhe vetëdijësuese në shkolla për të rinjtë rreth strehimit familjar	4. Zhvillimi i përbajtjeve informuese në platformat online të komunës për strehim familjar në komunën e Lipjanit					
Sigurimi i mjeteve mjaftueshme financiare për mbështetjen e Familjeve Strehuese në Lipjan	1. Subvencionimi i familjeve strehuese nga komuna 2. Pako për shërbime shëndetësore 3. Kontraktimi i partnereve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për familjet strehuese 4. Identifikimi i donatoreve potencial për	1. Takimi me Komitetin Politikë Financa 2. Propozim vendimi për subvencionim 3. Hartimi i ToR për kontraktim të partnerëve 4. Vlerësimi i aplikantëve/proje kteve 5. Kontraktimi dhe implementimi 6. Identifikimi i donatoreve potencial dhe	2025-2027	-vendimi për subvencionim -implementimi i projekteve të kontraktuara -ngritja e numrit të donatoreve -numri i marrëveshjeve të nënshkruara	Zgjerimi i shërbimeve për Familjet Strehuese nëpër mbështetje financiare të qëndrueshme	~ të konfirmohet nga komuna (mesatarja e 3 viteve të fundit – OJQ për shërbime sociale)	DSHMS; Drejtoria e Financave; OJQ-të;

Përfshirja e fëmijëve strehim në institucione parashkollore dhe shkollore	përkrahjen e familjeve strehuese	përpilimi i listës së tyre 7. Zhvillimi i takimeve me qëllim të thithjes së fondeve nga donatorët potencial	2025-2027	- lidhja e MoU me institucionet private - numri i fëmijëve të regjistruar - numri i fëmijëve të rikthyer në shkolla	Rritja e përfshirjes së fëmijëve në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës	IP Private; OJQ-të; Prindërit Strehues
Përfshirja e fëmijëve në strehim në institucione parashkollore dhe shkollore	1. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet private dhe publike për përfshirjen e fëmijëve 2. Marrëveshje bashkëpunimi me OJQ për ngritjen e vetëdijes dhe ofrimit të shërbimeve në funksion të parandalimit të braktisjes të shkollave, stilet e	1. Identifikimi i institucioneve private 2. Realizimi i takimeve 3. Nënshkrimi i marrëveshjeve 4. Shtimi i takimeve koordinuese të EPRBM 5. Implementimi i planit të veprimit të EPRBM				

S	prindërim, fëmijëria e hershme	1. Hartimi i kërkesave karshi donatorëve sipas nevojave të fëmijëve bazuar në Planin Individual Zhvillimor 2. Realizimi i intervenimeve të nevojshme nga komuna për mundësi të barabarta të qasjes 3. Angazhimi i një profesionisti për ofrimin e shërbimeve të dala nga PIZH. 4. Sigurimi i shërbimeve fizio-terapeutike 5. Garantimi i angazhimit të	2025-2027	- Familjet Strehuese të pajisura me intervenimet e nevojshme për qasje - kërkesat e nënshkruara me donatorët	Përmirësimi i qasjes së fëmijëve me aftësi kufizuara në shërbime dhe edukim		Drejtoria e Investimeve kapitale/e infrastrukturës Donatore; OJQ-të;
---	--------------------------------	---	-----------	--	---	--	--

Ngritja e kapaciteteve profesionale aktereve relevant	1. Zhvillimi i trajnimeve 2. Shkëmbimi i përvojave të profesionistev e me përvojë në strehim familjar me vende të tjera 3. Punëtori për ngritje të kapaciteteve të akterëve kyç (DSHMS, DKA, QPS)	asistentit për nevoja të veçanta arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara në strehim familjar. 1. Angazhimi i një eksperti ose grupi të eksperteve 2. Kontraktimi i psikologut të licencuar për ofrimin e supervizionit për punëtorët social 3. Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira 4. Organizimi i punëtorive për ngritje te kapaciteteve te akterëve kyç me	2025-2027	-realizimi i së paku 6 sesioneve në vit për supervizion -së paku 1 vizitë studimore në vit -së paku një punëtori në vit	Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e shërbimeve sociale në nivel lokal dhe kombëtar	~ 900€ zhvillimi i punëtorive; ~ 10,000€ vizitat studimore	DSHMS; OJQ-të; Donatorët Z.P
---	--	---	-----------	--	---	--	------------------------------

[illegible]

MONITORIMI

Plani Komunal i Veprimit për Strehim Familjar në Komunën e Lipjanit (2025-2027) do të përfshijë një sistem të fuqishëm monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar suksesin e tij. Monitorimi i regullt i progresit dhe vlerësimi i ndikimit të masave të ndërmarra janë thelbësore për të përmirësuar vazhdimisht politikën dhe strategjinë.

Ndërtimi i një sistemi të tillë është prioritet, pasi do të përmirësojë komunikimin, do të sigurojë reagim të shpejtë ndaj nevojave të qytetarëve dhe do të mundësojë vlerësimin efektiv të stafit.

Për të arritur këtë, do të ndërmerren hapat e mëposhtme:

1. **Themelimi i Grupit të Monitorimit:** Një grup i dedikuar do të krijohet për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Veprimit.
2. **Takime të Rregullta:** Grupi do të zhvillojë takime tremujore për të diskutuar progresin dhe sfidat.
3. **Përpilimi i Raporteve:** Raporte të rregullta do të përgatiten, duke paraqitur rezultatet e monitorimit, sfidat aktuale, propozimet për përmirësime dhe hapat e ardhshëm.

Grupi punues nga Komuna e Lipjanit:

1. Shkëlzen Hajdini- Drejtor për shëndetësi dhe përkujdesje sociale- DSHPMS
2. Ibrahim Duriqi- Drejtor Komunal për Arsimit- DKA
3. Makfite Shamolli- Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale, Lipjan
4. Lorik Bërbatovci- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
5. Fjolla Ibrahim- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
6. Gjyljeta Reçica- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
7. Zyrafete Mavriqi Bytyqi- Qendra për Punë Sociale, Lipjan

8. Luljeta Reqica- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
9. Suzana Mehmeti- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
10. Kimete Ratkoceri- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
11. Sevdija Syleviq- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
12. Hyrije Qerkini- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
13. Pranvera Shabani- Qendra për Punë Sociale, Lipjan
14. Qefsere Sllamniku- Qendra për Punë Sociale, Lipjan

Grupi punues mbështetës:

1. Remzije Krasniqi- SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
2. Mjellma Luma- SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
3. Ariana Shala- SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
4. Ora Bytyçi- SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
5. Besnik Peci- SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
6. Nita Luzha- SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë
7. Premtim Fazliu- Konsulent në procesin e hartimit të Planit Komunal të Veprimtë për strehim familjar për Komunën e Lipjanit

****Ky plan është hartuar me përkrahjen profesionale dhe teknike të SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë.***